

## KONTRATË SHITJE AKSIONESH

Sot më datë 16/06/2025, në Tiranë, palët e mëposhtme vendosën të lidhin kontratën e shitjes së aksioneve si më poshtë:

**SHITËSI:** Shoqëria "ARMAAR GROUP" shpk, person juridik i të drejtës shqiptare, me NIPT M01517007J, me seli në adresën Rruga "Muhedin Llagami", Pallati Vala, K.1, Tiranë, përfaqësuar nga administrator, z. Klaisi Çela i datëlindjes 18.09.2001, mbajtës i letërnjoftim ID me numër personal K10918054L. (në cilësinë e **Shitësit**).

DHE

**BLERËSI:** Shoqëria "ALBANIAN SMART BUSINESS SOLUTIONS" sha, person juridik i të drejtës shqiptare, me NIPT L11929003D, me seli në adresën Rruga "Ukraina e Lire", Pallati Teknoprojekt, Kati 7, Ap. 4, Tiranë, përfaqësuar nga administrator, z. Gëzim Kapxhiu, i datëlindjes 12.02.1967, mbajtës i letërnjoftim ID me numër personal G70212144H. (në cilësinë e **Blerësit**).

**OBJEKTI:** Shitja e 466,667 (Katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) aksioneve të "BANKA CREDINS" sh.a, që zotërohen nga aksioneri **Shoqëria "ARMAAR GROUP" shpk** dhe blerja e tyre nga **Shoqëria "ALBANIAN SMART BUSINESS SOLUTIONS" sh.a.**

### **NENI 1**

#### **PËRMBAJTJA E KONTRATËS**

- 1.1 Shoqëria "BANKA CREDINS" sh.a., është një shoqëri anonime e krijuar e që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 28969, datë 31.01.2003, e regjistruar në Organet Tatimore me Kodin Fiskal Nr. 3709529, NIPT K31608801O, si dhe me licencën nr. 16, datë 31.03.2003 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

### **NENI 2**



#### **ÇMIMI I SHITJES SË AKSIONEVE DHE MËNYRA E PAGESËS**

- 2.1 Palët kanë rënë dakord që 466,667 (Katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) aksione të shiten me çmimin total prej 700,000 (Shtatëqind mijë) Euro ("**Çmimi i shitjes**").
- 2.2 Pagesa në shumën e mësipërme do të kryhet në rrugë bankare nga ana e Blerësit dhe do të derdhet në llogarinë e Shitësit pranë Bankës Credins.

### **NENI 3**

#### **MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE**

- 3.1 Shitësi është plotësisht dakord dhe i shet me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë **Blerësit** 466,667 (Katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) aksione të shoqërisë "BANKA CREDINS" sh.a, që ai zotëron në kapitalin aksionar të Bankës.
- 3.2 Kalimi i pronësisë do të bëhet me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe pagesën e  $\frac{1}{4}$  të shumës 700,000 (Shtatëqind mijë) Euro nga ana e Blerësit Shoqëria "ALBANIAN SMART BUSINESS SOLUTIONS" sha, në llogarinë e Shitësit Shoqëria "ARMAAR GROUP" sh.p.k.
- 3.3 Kjo pagesë, pra  $\frac{1}{4}$  e çmimit të shitjes ose 175,000 (Njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) Euro, do të behet nga ana e pales Blerëse në favor të pales Shitëse, brenda dates 20 Qershor 2025.
- 3.4 Diferenca e mbeturur, pra  $\frac{3}{4}$  e çmimit të shitjes ose 525,000 (Pesëqind e njëzet e pesë mijë) Euro, do të behet nga ana e pales Blerëse në favor të pales Shitëse, brenda dates 30 Korrik 2025





#### NENI 4

##### KLAUZOLAT PËR TË DREJTAT MBI DIVIDENTIN DHE TË TJERA

- 4.1 Aksionet objekt kontrate kalojnë dhe transferohen tek Blerësi së bashku me të gjitha të drejtat që shoqërojnë dhe lidhen me aksionet, përfshirë çdo lloj dividendi, rritje kapitali, e drejta e votës, dhe në përgjithësi çdo lloj e drejte tjetër e papërmendur, por që njihet nga statuti dhe ligji.
- 4.2 Palet përcaktojnë se:
- 4.2.1 Me nënshkrimin e kesaj kontrate të gjitha të drejtat dhe perfitimet financiare lidhur me paketën e aksioneve që blihen dhe transferohen (sipas kesaj kontrate) do të kalojnë, perlllogariten dhe paguhen në favor të bleresit shoqëria "ALBANIAN SMART BUSINESS SOLUTIONS" sh.a.. Tek keto të drejta në menyre referuese përmendim çdo lloj dividendi dhe perfitimi financiar që lidhet me zoterimin e aksioneve dhe benefitet e atashuara me kete pakete aksionesh;
- 4.2.2 Shitesi ruan dhe gezon *ipso jure* kredine mbi objektin e kesaj kontrate per pagimin e çmimit të shitjes.
- 4.2.3 Palet bien dakord per të drejten e shoqërisë "ALBANIAN SMART BUSINESS SOLUTIONS" sh.a., që ti shes/disponoj aksionet (i.e. *paketën e aksioneve objekt i kesaj kontrate*), tek të tretet e interesuar, sipas kushteve të dakordesuara rast pas rasti, në vijim të regjistrimit të pronësise mbi keto aksione në favor të shoqërisë "ALBANIAN SMART BUSINESS SOLUTIONS" sh.a., sipas kesaj kontrate, me kushtin që çdo e ardhur nga tjetërsimi i kesaj pakete aksionesh në favor të të tretëve të kaloj në favor të shlyerjes së shoqërisë "ARMAAR GROUP" sh.p.k. per llogari të shlyerjes së çmimit të shitjes (nese nuk eshte likuiduar).

#### NENI 5

##### LIGJI I ZBATUESHËM

- 5.1 Palët bien dakord që kjo Kontratë do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për çfarë nuk parashikohet në këtë Kontratë aplikohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë mbi shitjen, si dhe përgjithësisht legjislacioni në fuqi.

##### TË TJERA

Kontrata hartohet në 4 kopje origjinale, duke patur të gjitha vlerë të njëjtë, nënshkruhet prej palëve me dëshirë dhe vullnetin e tyre të plotë e të pavesuar.

##### SHITËSI

Shoqëria "ARMAAR GROUP" SH.P.K

Përfaqësuar nga Administratori

Klasi Çela



##### BLERËSI

Shoqëria "ALBANIAN SMART BUSINESS SOLUTIONS" SH.A

Përfaqësuar nga Administratori

Gëzim Kapxhiu

*Gëzim Kapxhiu*  
*[Signature]*

